



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 3189 Prot

Jt. 31.05.22



Nr. 289/ 2 Prot.

Shkodër, më 27.05.2022

Lënda: Mbi Vendimin nr. 26 dhe 27, datë 29.04.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, pas administrimit të shkresës së ZABU Drin-Bunë nr. 179/1prot., datë 24.05.2022 përgjigje e shkresës së Prefektit nr.289/1 prot datë 13.05.22 me objekt “Kërkesës për trajtim”, me anë të së cilës i është kërkuar nëse sipërfaqet e parashikuara për dhenie në qira në VKB Vau Dejës nr. 26 dhe 27, përfshihen në brixhet e liqenit të Vau Dejës, na konfirmohet se janë nën administrimin e Zyrës së Administrimit të Basenit Drin-Bunë.

Referuar ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.2, gërma a, neni 27, pika 5, neni 54, shkronja “e/1”, neni 55, pika 3, të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, neni 25, është në tagrin e këshillit bashkiak të japë në përdorim prona me qëllim nxjerrjen e të ardhurave, një e drejtë kjo e padiskutueshme, por këto praktika trajtohen edhe sipas ligjit të posaçëm nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar dhe ka një regjim të ndryshëm juridik, për të cilat ju jeni të detyruar të respektoni se kërkesat për veprimtari ndërtimore të cilat duhet të jenë për qëllime publike dhe mund të ushtrohen vetëm pasi të merret autorizimi i posaçëm nga organet e menaxhimit të burimeve ujore (Basenit Ujor Drin-Bunë) duke respektuar njëkohësisht nenin 67 të ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË



VENDIM

Nr. 26 datë 29.04.2022

“Për dhënien në përdorim me afat 10 vjecar sipërfaqen pyjore prej 1.02 ha për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj), dhe bën pjesë në ngastrën nr.39a në ekonomine pyjore Gomsiqe.

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 57/2020, date 30.4.2020 “Për Pyjet”, neni 25, **pika 49** e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” **me shumicë të cilësuar votash.**

VENDOSI

1. Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes në total **1.02** ha për qëllime pushime argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj” qe bën pjese në **ngastrën nr.39a** në ekonomine pyjore **gomsiqe**, sipas listës së inventarit, **shtojca nr.47** dhe janë në pronësi/administrim të Bashkise Vau Dejës.
2. Afati i dhënies me qera të jetë 10 (dhjete) vjet.
3. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM nr.1064, date 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.
4. Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti , sigurohen të ardhura të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
5. Ngarkohen Drejtoria e pyjeve, Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETAR
Mark Bisha

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Ardian Çelepija

Miraturar me 21 vota

Vota Pro 21

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 05.05 2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SE MJEDISIT
Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

Nr. 22 prot.

Vau Dejës, më 23.01.2022

RELACION

Për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj)

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Administrimi i fondit pyjor dhe kullor në territorin e Bashkisë Vau u Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku në piken 5 të këtij neni përcaktohet: **Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:**

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, sipas legjislacionit në fuqi.*

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor është ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.2 c, neni 54 pika e1 neni 18, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë, dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” pika 7.

Siperfaqja e marre ne studim do te dale ne ankand nepermjet procedures se prokurimit publik sipas legjislacionit ne fuqi.

Siperfaqja që planifikohet të jepet në përdorim është 1.02 ha.

Në funksion të siperfaqes që merret në përdorim, sipas VKM-venë nr.1064, date 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” lidhja 2 pika 5/3, **si me poshtë.**

5. Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike kampingje (kënde lodrash, mjedise sportive, shlodhëse etj.)					
Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit			
		1 vit	2-5 vjet	6-10 vjet	
1	Pyll trungishte	180 000	120 750	100 000	
2	Pyll cungishte	126 000	90 000	75 000	
3	Pyll shkurre	126 000	90 000	75 000	
4	Kullota	126 000	90 000	75 000	
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	90 000	52 000	45 000	
6	Inproduktive	90 000	52 000	45 000	

Vlera totale e pagesës/vit është 76 500 (Shtatedhjetë e gjashtë mijë e pesëqind)lekë

Bazuar në sa më sipër, propozojmë miratimin e dhënies me qira të sipërfaqes prej 1.02ha .

Bashkëlidhur po ju dergojmë.

1.Dokumentacionin e plote dhe harten e ekonomise.

Duke ju falënderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit.

Ing.Mark Suli



**Specialistet
Ing.Esmeraldo Harapi**




Miratoi

Drejtori

Rrok Ftoni



Ing.Zeqir Ujka



RAPORT

MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM/HEQJE NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË VAU DEJËS

“PËR QËLLIME PUSHIMI, ARGËTIMI, SHENDETSORE, SHOQERORE DHE PËR VËPRIMTARI TURISTIKE, KAMPINGJE (KËNDE LOJRASH, MJEDISE SPORTIVE, SHLODHËSË ETJ)”

Bazuar në Urdhërin **nr.5, datë 12.01.2022** të Kryetarit të Bashkisë për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore për dhënie të fondit pyjor me qira “për qëllime pushimi, argëtimi, shendetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj)”

Grupi i punës i përbërë nga z. Zeqir Ujka, Përgjegjes i sektorit të pyjeve z. Mark Suli, specialist i menazhimit të pyjeve, z. Esmeraldo Harapi specialist kadastrë nga data **23.02.2022** deri në datën **24.02.2022**, realizoi verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqes kullosore me objekt dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore **1.02** ha “për qëllime pushimi, argëtimi, shendetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj)”

Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor sipas VKM nr.433, datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të Bashkisë të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/Bashkisë, rezultoi që sipërfaqja e kërkuar që merret në përdorim është **1.02** ha për qëllime pushimi argëtimi, shendetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj)” dhe bën pjesë në **ngastren nr.39 a** në ekonomine pyjore **gomsiqe**, sipas listës së inventarit, **shtojca nr.47** dhe janë në pronësi/administrim të Bashkisë Vau Dejës.

Përshkrimi parcellar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në tabelat 1 dhe 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezultoi kjo gjendje: *(sipas tabelave përkatëse Bashkelidhur).*

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin jepen në përdorim për një afat **10 vjet** një sipërfaqe prej **1.02 ha** për qëllime pushimi, argëtimi, shendetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj).

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor publik janë të mbështetura në V.K.M-ve nr. 1353, datë 10.10.2008, të ndryshuar “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, në VKM-ve nr 1374, date 10.10.2008, të ndryshuar “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”. Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” pika nr 2 germa (a) dhe 7.

Sipërfaqja e marre në studim do të dale në ankand nepermjet procedures se Konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.

Pas miratimit të raportit tekniko - ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, kryetari Bashkise nxjerr urdherin për pregatitjen e dokumentave të ankandit nepermjet procedurës së konkurimit publik

Tarifat e dhënies në përdorim nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-venë nr.1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” lidhja 2 pika 5/3, si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit. **Shuma në lekë/vit konsiston në:**

1. Vlerën e përdorimit leke/ha/vit

a) Ngastra nr 39a Shkurre 1.02 ha x 75 000 lekë/ha = **76 500** lekë

Në total 76 500 (Shtatedhjetë e gjashtë mijë e peseqind)lekë

PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK


Ing.Zeqir Ujka



Ing. Mark Suli



Ing. Esmeraldo Harapi



KRYETARI

MARK BABANI



Bashkia Vau Dejës

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR (sipas regjistrit kadastral)

Per qellime shogerore,pushime ,argetimi,etj
Formulari nr.1

ID.	Ekonomia Pyjore	Parcela	Sip.Tot. ha	Perbejta grumbullit	Funksion i	Forma	Mosha	K.D	Te dhena te grumbullit pyjor					Fuqia lendore	
									D mes	Lart. mes	Filizzeria	Nen pylli	Kat et	Per ha	Total
SH67 00 039a	Gomsiqe	39a	46.67	mare	prodhues	shkurre	35	0.6	6	4	0	0	0	57.7	2600
			46.67				0	0	0	0	0	0	0	57.7	2600

Bashkia Vau Dejës

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR (sipas verifikimit ne terren) Per qellime shogerore,pushime ,argetimi,etj

Formulari 2

ID.	Ekonomia	Parcela	Sip.Tot.	Perbejta grumbullit	Funksion	Forma	Mosha	K.D	Te dhena te grumbullit pyjor					Fuqia lendore	
									D mes	Lart. mes	Filizzeria	Nen pylli	Kat	Per ha	Total
SH67 00 039a	Gomsiqe	39a	46.67	mare	prodhues	shkurre	35	0.6	6	4	0	0	N	57.7	2600
			46.67											57.7	2600

PLOTESOL:

Ing.Mark Suli



Ing. Zeqir Ujka



Ing. Esmeraldo harzpi



Bashkia Vau Dejës

LISTA E NGASTRAVE, N/NGASTRAVE TË FONDIT PYOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË HIQEN/JEPEN NË PËRDORIM
Per qellime shqerore,pushime ,argetimi,ej

Formulari 5

Nr.	ID Prones	Ekonomia Pyjore/kull osore	Ng/neng,nr.	Sipërfaqje qe hiqet nga fondi pyjor/kull osor	Sipërfaqja			Tubacion/ kanal
					Sipërfaqje qe jepet ne perdorim nga fondi pyjor/kull osor ha	Gjatesia ne Rruge km	perdorim Linje	
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1	SH67 00 039a	Shosh 2	39a	0	1.02	0	0	0
Shuma					1.02			

PLOTESOI:

Ing. Mark Suli



Ing. Zegir Ujka



Ing. Esmeraldo hatrapi



Bashkia Vau Dejës

TABELA PERMBLEDHESË E VLËRESIMIT FINANCIAR
Per qellime shqerore, pushime ,argetimi etj.

Formulari nr.4

Perdorimi I territorit	Sip ha	Bashkia	Volumi ne m ³ sipas asortimenteve	Sasia	Vlera Leke /m ³	Shuma I	Gjatesia e perdorimit rreze ne km	Tarifa dhenje ne perdorim lek/ha/vit			Shuma II	Totali I+II
								1	2.-5	6.-10		
0	1	2	3		4	5	6	8	9	10	11	12
Pyll	1.02	V.Dejës	0	0	0	0	0	126 000	90 000	75 000	76 500	76 500
Gjuetia	0	V.Dejës	0		0	0	0	0	0	0	0	0
Invest	0	V.Dejës	0		0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsejt	1.02				0	0	0				0	76 500

PLOTESOI:

Ing. Mark Suli




Ing. Zegir Ujka



Ing. Esmeraldo harapi



Ekonomia Pyjore Gomsqie SH 1:10 000



[Handwritten signature]